

Arlinda Memetaj, PhD.¹

UDC:
35.08(497.115)

**NDËRTIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË DREJTËSISË
ADMINISTRATIVE SI NJË NGA SFIDAT MË TË MËDHA TË
PROCESIT TË KONSOLIDIMIT SHTETËROR TË KOSOVËS**

**ГРАДЕЊЕТО НА НАЦИОНАЛНИОТ СИСТЕМ НА
АДМИНИСТРАТИВНАТА ПРАВДА, КАКО ЕДНА ОД
НАЈГОЛЕМИТЕ ПРЕДИЗВИЦИ НА ПРОЦЕСОТ НА
ДРЖАВНА КОНСОЛИДАЦИЈА НА КОСОВО**

**CONSTRUCTION OF THE NATIONAL ADMINISTRATIVE
JUSTICE SYSTEM AS ONE OF THE LARGEST CHALLENGES OF
THE KOSOVO STATE COSMOSITY PROCESS**

Abstract

State administrative bodies are the main points of interaction between private people on the one hand and the state on the other hand. Administrative acts have decisive and direct action in the daily lives of private persons of each state. Therefore, even the best political concepts of each state, which directly relate to issues of interest to citizens, always end without success if the public administration of that state lacks the right capacity for the practical application of those concepts in social reality. This is also confirmed by the fact that issues related to public administration and local self-government are part of the agendas of almost every relevant international non-governmental organization, including the UN, the Council of Europe and the EU. Their long-standing activity has adopted numerous legal-political documents in

¹ Profesor në Universitetin FON - Shkup

this sphere. The process of reforming its public administration, the Republic of Kosovo has started since the declaration of independence in 2008. The Constitution of R. of Kosovo successfully established the basic national framework for the development of the state administrative-judicial justice system and the local self-government system. This paper emphasizes the need for the establishment of a special administrative court in the state, the strengthening of the country and the role of the Ombudsman, the provision of real conditions for good local governance and municipal efficiency, which implies the increase of institutional and professional capacity for the implementation of The Law on General Administrative Procedure.

KEY WORDS: Administrative justice, administrative procedure, administrative courts, European Human Rights Court, human rights, monitoring, reform, benefit.

Hyrje

1. Rreth domosdoshmërisë së ekzistimit të kontrollit në punën e administratës publike nëpërmjet sistemit të drejtësisë administrative

Nevoja për mbështetje gjithëpërfshirëse të institucioneve dhe proceseve demokratike gjithnjë e më shumë e thekson rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjeve që lidhen me administratën publike të çdo shteti modern dhe respektimin e parimit themelor të sundimit të ligjit. Duke u nisur nga konstatimi i mësipërm, më se e qartë është se ekzistimi i një administrate transparente dhe të përgjegjshme është pjesë përbërëse e një shoqërie demokratike. Themi kështu duke u nisur nga fakti se “qeverisja” nuk nënkupton asgjë tjetër pos “ushtrimin e pushtetit politik në përditshmërinë e qytetarëve”. Duke i miratuar aktet dhe organet administrative të çdo shteti, përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave privat-fizik dhe personave juridik, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Pikërisht, duke i pasur parasysh aktivitetet dhe obligimet e shumta që i ofron çdo administratë publike, nuk duhet e as nuk guxon të lihet jashtë kontrollit të shoqërisë, sepse si pasojë e mungesës së kontrollit rezultojnë shkelje dhe keqpërdorime të të drejtave të personave privat nga administrata publike. Me këtë, faktikisht konfirmohet rëndësia e jashtëzakonshme e të drejtës për drejtësi për çdo person privat (fizik apo juridik) në rrethin administrativ,

e drejtë e cila faktikisht është një nga parakushtet themelore për të pasur administratë publike transparente dhe të përgjegjshme si pjesë përbërëse e qeverisjes demokratike. Procesi i realizimit të së drejtës për kontestimin e akteve administrative zhvillohet në dy nivele: niveli i parë është procedura administrative, vegël demokratike e krijuar për të mbrojtur personat privat (fizik dhe juridik) gjatë komunikimit të drejt-përdrejtë me organin administrativ shtetëror relevant², ndërsa niveli i dytë i përket makinerisë administrative-gjyqësore, nëpërmjet të së cilës personat privat, në mënyrë plotësuese mund t'i kontrollojnë veprimet administrative. Në fakt, të dy këto nivele e përbëjnë thelbin e çdo sistemi të së drejtës administrative.

Sa i përket procedurës administrative (PA) duhet të theksojmë faktin se ligjet procedurale administrative i stimulojnë parimet kryesore të PA-së dhe llogariten si vegla tradicionale të çdo demokracie, qëllimi i të cilave është operacionalizimi i garancive themelore kushtetuese për mbrojtjen e individëve prej keqpërdorimeve eventuale nga pushteti administrativ shtetëror. E lidhur ngushtë me nivelin e parë është gjykata administrative (GJA), përkatësisht gjykatat të cilat monitorojnë veprimet administrative dhe të cilat në mënyrë efektive bëjnë vlerësimin e ligshmërisë së akteve konkrete administrative³. Këto dy nivele të kontrollit nuk janë të ndara. Procedurat administrative dhe gjykata administrative, shikuar nga cili do kontekst demokratik kombëtar, de facto janë dy shtyllat kryesore të sistemit të mbrojtjes juridike të të drejtave të personave privat (fizik dhe juridik) në një rreth të caktuar administrativ.

Natyrisht, procesi i ilustruar më lart për zbatimin e parimit për të pasur një administratë publike transparente dhe të përgjegjshme përmes sistemit të drejtësisë administrative, është përforcuar me forma të tjera ekzistuese të kontrollit politik dhe ligjor mbi autoritetet administrative shtetërore, ku veçanërisht përfshihet kontrolli parlamentar dhe ai që e kryejnë organe të ndryshme kombëtare të pavarura të monitorimit, siç

² Termi procedurë administrative përfshin kornizën formale kryesore procedurale të domosdoshme për realizimin e të drejtave, obligimeve dhe interesave juridike të personave fizik e juridik vis-à-vis administrates, të rregulluara me dispozitat e veçanta apo material. Shih te Grizo, N., Gelevski, S., Davitkovski B., & Pavlovska-Daneva A. (2008). E drejta administrative [Administrative law]. Skopje, Republic of Macedonia: Iustinianus Primus Faculty of Law in Skopje.

³ Гелевски, С, Судска контрола над управни акти, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010, стр.149

janë Avokati i Popullit, mediat, organizatat joqeveritare etj.⁴ Kjo e fundit nënkupton përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje, si një nga elementet më themelore të demokracisë. Pikërisht ky element është më i përshtatshëm të pasqyrohet në procesin e decentralizimit, gjegjësisht në sistemin e qeverisjes lokale, i cili ka autoritetin e vet administrativ.⁵

Të gjitha pikat e rëndësishme të theksuara më lart në lidhje me përgjegjshmërinë e administratës publike dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, janë të përfshira thellësisht në agjendën e pothuajse të të gjitha organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare ndërqeveritare, si OKB-së, Këshillit të Evropës dhe BE-së. Të gjitha këto subjekte kanë miratuar një sërë dokumentesh përkatëse ligjore rreth politikave të kësaj fushe, qëllimi i të cilave është promovimi i koncepteve dhe parimeve themelore, siç është parimi apo e drejta për qeverisje të mirë, hapësira administrative evropiane etj. Mirëpo, promovimi i tyre në plan kombëtar dhe në veçanti zbatimi i tyre në praktikë është i pamundur pa ekzistimin e sistemit funksional juridik administrativ-gjyqësor të lartpërmendur.

2. Vendi dhe roli i Këshillit të Evropës. Vlera e shtuar e përvojës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e drejtësisë administrative

Këshilli i Evropës ka kryer aktivitete të shumta legislative në fushën e së drejtës administrative. Në fillim, këto aktivitete u bënë shumë evidente për gjithë botën kur Komiteti i Ministrave i kësaj organizate e miratoi Rezolutën (77) 31 për mbrojtjen e individit në relacion me aktet e organeve administrative. Në vitin 1980, kjo rezolutë u përcoll nga Rekomandimi nr. (80) 1 për ushtrimin e kompetencave diskrecionale nga autoritetet administrative. Ky nuk ishte aspak një zhvillim i rastësishëm pasi pikërisht në mandatin e kësaj organizate gjendet funksioni kryesor: garantues i demokracisë, sundimit të ligjit

⁴ See at Victor O Ayeni, THE OMBUDSMAN IN THE ACHIEVEMENT OF ADMINISTRATIVE JUSTICE AND HUMAN RIGHTS IN THE NEW MILLENNIUM, Published in International Ombudsman Journal, Volume 5, 2001, pp. 32-53.

⁵ Guidelines for civil participation in political decision making, adopted by the Council of Europe Committee of Ministers in 2017. See also Western Balkans Recommendation on Public Participation, as endorsed by ministers in charge for public administration from Western Balkan countries at the ReSPA Governing Board meeting held on 6 November 2017 in Tirana, Albania.

dhe të drejtave të njeriut në Evropë. Inputin specifik të Këshillit të Evropës më qartë e konfirmon Rekomandimi (Rec. 92007) 7 i miratuar nga Komiteti i Ministrave të tij mbi "qeverisjen e mirë"⁶, aneksi i të cilit përmban Kodin e Administrimit të Mirë, ku përcaktohen të gjitha parimet kryesore, si: parimet e ligjshmërisë, barazisë, paanësisë dhe proporcionalitetit, parimi i sigurisë juridike, parimi i veprimtimit brenda një afati të arsyeshëm kohor, parimi i pjesëmarrjes, parimi i respektimit të privatësisë dhe parimi i transparencës. Përveç parimeve të lartpërmendura, Kodi përmban gjithashtu një sërë rregullash që rregullojnë vendimet administrative, ku përfshihet dhënia e të drejtës për personat privat dhe shqyrtimi gjyqësor i vendimeve administrative si dhe të drejtën e tyre për kompensim për dëmet e shkaktuara nga një vendim i paligjshëm ose mospërfillje nga organet administrative.

Ngjashëm me parimet e qeverisjes së mirë, Këshilli i Evropës i ka kodifikuar edhe parimet e kontrollit gjyqësor ndaj akteve administrative, i cili kodifikim është bërë sipas Rekomandimit Rec (2204) 20 të Komitetit të Ministrave për vendet anëtare të kësaj organizate⁷. Në këto parime përfshihen: parimi i arritjes së kontrollit gjyqësor; dhënia e mundësisë për kontroll; domosdoshmëria për të pasur një gjykatë të pavarur e të paanshme; e drejta për gjykim të drejtë dhe efikasiteti i kontrollit gjyqësor. Në kontekst të parimeve të lartpërmendura, duhet të theksohet fakti se këto parime duhet parë nga aspekti i lidhjes së ngushtë komplementare me të gjitha rekomandimet relevante dhe konventat e Këshillit të Evropës⁸, siç është për shembull Karta e Evropës për Vetëqeverisje Lokale dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, përfshirë këtu edhe praktikën shumë të rëndësishme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁹.

Në këtë drejtim, Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ) është instrumenti ndërkombëtar evropian juridik më kryesori, më i njohuri dhe i pari që garanton një gamë të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë, të drejtën për përdorim efikas të instrumentit si

⁶Recommendation CM/Rec(2007)7 of the Committee of Ministers to member states on good administration, i miratuar më 20 qershor 2007.

⁷Ky rekomandim është miratuar më 15 dhjetor të vitit 2014.

⁸Më tepër për rekomandimet e Komitetit të Ministrave, shih në: www.coe.int/CM

⁹Regional School of Public Administration (ReSPA), Study on the Case-Law of the European Court of Human Rights Applicable in Administrative Disputes, 2017, available on: www.respaweb.eu

mjet juridik. Të gjitha këto janë shumë të rëndësishme për të drejtën administrative. Roli ekskluziv i kësaj konvente në sistemin e përgjithshëm juridik e politik të Këshillit të Evropës, nuk përfundon vetëm me ekzistimin e të drejtave individuale themelore të njeriut që i përmban ajo, porse po ky dokument bëhet më i rëndësishëm për faktin se vetëm në këtë konventë parashihet mbrojtje në rrugë gjyqësore të të drejtave të caktuara në të. Thënë me fjalë të tjera, duke u bazuar në këtë instrument, është themeluar dhe si i tillë funksionon tashmë i njohuri Gjyqi Evropian i të Drejtave të Njeriut¹⁰, qëllimi i vetëm i të cilit është të sigurojë zbatim dhe interpretim të drejtë të dispozitave që i përmban KEMDNJ-ja¹¹. Ky dokument është i rëndësishëm nga fakti se të gjithë personave-individëve u mundëson të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore nga kjo gjykatë për të drejtat dhe liritë e tyre (të garantuara me këtë konventë), respektivisht të mund të parashirojnë ankesë ndaj çdo shteti – si palë nënshkruese e konventës, organet e së cilës (ku bëjnë pjesë jo vetëm organet gjyqësore, por edhe ato administrative) kanë shkelur cilëndo të drejtë apo liri të paraparë me këtë instrument¹².

Shikuar nga prizmi i qëllimit kryesor të këtij punimi, rol të ngjashëm dhe tërësisht plotësues në këtë drejtim ka edhe Bashkimi Evropian, të arriturat normative të të cilit në mënyrë më eksplicite janë verifikuar (mes tjerash) me inkorporimin e Kartës së të Drejtave Themelore në Marrëveshjen e Lisbonës, me të cilën garantohej “e drejta për administratë të mirë”¹³.

Sa i përket Kartës së BE-së së të drejtave themelore, nga perspektiva e qëllimit kryesor të këtij punimi, duhet të theksohen tri dispozitat e saj speciale: e drejta për administratë të mirë (neni 41), e drejta e aksesit në dokumente (neni 42) dhe e drejta e referimit të Avokati i Popullit (neni 43). Por, përveç kësaj, kjo kartë përmban edhe dispozita tjera, të cilat kanë ndikim në veprimet dhe strukturat administrative dhe të cilat njëkohësisht janë pjesë e përmbajtjes së konceptit të “administratës së mirë”, ashtu siç është e drejta e peticionit në Parlamentin e Evropës (neni 44), e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale (neni 8),

¹⁰ Më shumë për Gjykatën shih në: www.coe.int/court

¹¹ David Harris, et al, *Law of the European Convention on Human Rights*. (2nd ed., Oxford University Press, 2009)30.

¹² Bradley, A. W., “The European Convention on Human Rights and Administrative Law: First Impressions”, (1983) 21 *Osgoode Hall Law Journal* 4, p. 615.

¹³ CHARTER OF FUNDAMENTAL RIGHTS OF THE EUROPEAN UNION, Official Journal of the European Communities C 364/1.

të qenit i barabartë para ligjit (neni 20), mosdiskriminimi (neni 21), e drejta për diversitet kulturor, fetar e gjuhësor në BE (22) parimi i barazisë gjinore (neni 23), qasja në shërbimet që janë me interes të përgjithshëm ekonomik (neni 36), e drejta në përdorimin e mjetit juridik efikas dhe gjykim të drejtë (neni 47). Pikërisht në këtë prizëm shihet edhe roli i rëndësishëm i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (instancë gjyqësore e BE-së), përvoja gjyqësore e së cilës, (ngjashëm me Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut) ua shton peshën këtyre të drejtave.

Në kontekst të kësaj dhe njësoj si edhe më lart (edhe pse në mënyrë të përgjithësuar) ishte mjaftueshëm e elaboruar, duhet të theksohet se vendet anëtare të BE-së as me marrëveshjen e re (gjegjësisht me Marrëveshjen e Lisbonës) nuk u morën vesh, madje as në një të ardhme të afërt nuk mund të pritët që ato të merren vesh për cilin do lloj të vetëm, respektivisht për një model të vetëm të administratës shtetërore në të gjitha vendet anëtare në BE. Bashkësia u imponon vendeve të saj anëtare obligime, realizimi i të cilave duhet të japë rezultatet e pritura, që do të thotë se ata janë të lirë të organizojnë administratën e tyre si të duan, por gjithsesi duhet të lëvizin në drejtimin që mundëson zbatim korrekt dhe adekuat të të gjitha obligimeve të parashtuara nga BE-ja në kontekst të realizimit të qëllimeve të politikave të përcaktuara¹⁴. Rrjedhimisht, BE-ja insiston në standarde, parime të inkorporuara në konventa, deklarata, rekomandime të ndryshme të miratuara nga organet dhe trupat e BE-së, në bazë të të cilave duhet të funksionojë dhe të ndërtohet çdo sistem administrativ i shteteve anëtare dhe i vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare. Këto standarde dhe parime janë për administrimin e mirë, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, administratën e orientuar ndaj tregut, administratën si shërbim publik në funksion të realizimit të të drejtave dhe lirive, etj. të cilat janë pjesë e të ashtuquajturit *acquis communautaire*¹⁵.

Pikërisht në drejtim të koncepteve të përgjithshme të ilustruar më lart, mund të kuptohet edhe përdorimi i konceptit të Hapësirës Administrative Evropiane (HAE), përmbajtja e së cilës duhet të kuptohet vetëm në kuptim të konsensusit të ilustruar më lart ndërmjet vendeve

¹⁴ Më shumë të shihet te: Koprić, I., Musa, A., & Lalić Novak, G. (2011). Good administration as a ticket to the European administrative space. *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, 61(5), 1515-1560.

¹⁵ Mendes, J. (2009). *Good Administration in EU Law and the European Code of Good Administrative Behaviour*. European University Institute, EUI Working papers, Law 2009/09, Department of Law: 1-19.

anëtare të BE-së në relacion me komponentët themelor të parimit të administrimit të mirë. Ky koncept veçanërisht ka lidhje me kriteret shumë të njohura të Kopenhagës për anëtarësim në BE, duke marrë parasysh këtu edhe kriterin shumë të rëndësishëm, të ashtuquajtur të Madridit, i cili imponon domosdoshmërinë e pasjes së një kapaciteti administrativ dhe gjyqësor që do të jetë në gjendje të implementojë të drejtën e Bashkësisë (acquis) nga secili shtet kandidat apo kandidat potencial për anëtarësim në BE. Në analogji dhe nga perspektiva e kësaj të fundit, shumë shpesh HAE-ja është definuar si një acquis joformal i BE-së, që merret me funksionimin e administratës publike. Krijimi i HAE-së, i parë si model i ofruar shteteve potenciale për anëtarësim, më së shumti vjen si rezultat i aktiviteteve të SIGMA-s¹⁶.

3. Korniza themelore kushtetuese dhe juridike e sistemit kosovar të drejtësisë administrative

Pikërisht në kontekst të të gjitha qëllimeve kryesore të ilustruara deri më tani, si çdo shtet i ish-Jugosllavisë, ashtu edhe Republika e Kosovës, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë më 2008, filloi me procesin e reformave në administratën publike dhe përforcimin e sistemit të drejtësisë administrative. Ky proces i reformave ishte një afirmim i qartë i aspirimit të saj të fortë për të qenë anëtare e barabartë (mes tjerash) në Këshillin e Evropës dhe Bashkësinë Evropiane. Veçanërisht institucioni i dytë është i rëndësishëm për faktin e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE-në (më 2016), në kuadër të së cilës gjendet edhe obligimi i saj kryesor për plotësimin e Kriteve të Kopenhagës tashmë të njohura për anëtarësim në BE. Këtu bën pjesë edhe kriteri plotësues (i ashtuquajtur i Madridit), sipas të cilit duhet të sigurohen kapacitete të zhvilluara kombëtare administrative dhe gjyqësore për zbatimin e përfitimeve të miratuara të përbashkëta (acquis) të BE-së. Ky konstatim i fundit nuk do të thotë se nuk

¹⁶ “Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit” (Support for Improvement in Governance and Management), nismë e përbashkët e BE-së dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH), e financuar nga BE-ja dhe e përkrahur nga OBEZH-i dhe Programi FARE i BE-së më 1992, për mbështetjen e vendeve partnere në reformat e administratës së tyre. Më shumë shih në: www.sigmaweb.org .

ekzistonte kurrfarë raporti bashkëpunues i Republikës së Kosovës me BE-në.¹⁷

Për nevojat e qëllimit themelor të këtij punimi, shikuar nga perspektiva e Kriterit të Madridit të përmendur më lart për anëtarësim në BE, në rastin e Republikës së Kosovës duhet të theksohet se është Kushtetuta e saj¹⁸, e cila (ashtu siç ishte rasti edhe me çdo shtet tjetër të rajonit të Evropës Juglindore) e siguroi dhe akoma vazhdon të ofrojë kornizën themelore juridike për zhvillim të sistemit të së drejtës administrative të shtetit. Në këtë drejtim, të rëndësishme janë dispozitat kushtetuese selektive që pasojnë: I). Neni 3, me të cilin garantohej parimi “Të barabartë përpara ligjit”, i cili parim akoma më shumë është përforcuar me dispozitën e nenit 24; II). Neni 7, “vlerat e rendit kushtetues të shtetit”, ku bëjnë pjesë mes tjerash, respektimi i të drejtave themelore të njeriut, ndarja e pushtetit shtetëror. Njëkohësisht, me nenin 3 të këtij ligji, garantohej edhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në sferat tjera shoqërore; III). Neni 12, i cili stimulon parimin veçanërisht të rëndësishëm të “Vetëqeverisjes lokale”, përmbajtja konkrete e të cilit është operacionalizuar në Kapitullin X, në kuadër të të cilit ndodhet neni 123, në paragrafin 3 të të cilit është paraparë që “Aktiviteti i organeve të vetëqeverisjes lokale të bazohet në këtë Kushtetutë dhe ligjet e Republikës së Kosovë duke e respektuar Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Republika e Kosovës do t’i përmbahet dhe do ta implementojë Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, një kusht i obligueshëm për çdo shtet nënshkrues të saj”. Kjo është e kompletuar me paragrafin 4 të nenit të përmendur, sipas të cilit “Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e administrimit të mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit për sigurimin e shërbimeve publike, me respekt të veçantë për nevojat specifike dhe interesat e bashkësive dhe anëtarëve të tyre, të cilat nuk janë shumicë”¹⁹. Rëndësia e kësaj dispozite është drejtpërdrejt e lidhur me dispozitën e nenit 22, me të cilin është përcaktuar zbatueshmëria e

¹⁷ Shih: European Partnership, Council Decision 2004/520/EC. Brussels. 14.06.2004; Communication from the Commission – A European Future for Kosovo, Com/2005/0156 final. Brussels. 20.04.2005.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës u miratua nga Kuvendi Popullor më 9 prill të vitit 2008, ndërsa hyri në fuqi më 15 qershor të vitit 2008. Official Gazette of the Republic of Kosovo, at <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

¹⁹ Në këtë kontekst, me rëndësi të veçantë është përmbajtja e neneve që i përmban kapitulli III i Kushtetutës, që rregullon të drejtat e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre.

drejtpërdrejtë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve, ku vend të rëndësishëm zë Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e cila (edhe pse nga aspekti formal-juridik nuk është ratifikuar) është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës (në bazë të nenit 19)²⁰ dhe e cila, në rast konflikti ka prioritet ndaj dispozitave ligjore apo akteve tjera të institucioneve publike. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Republika e Kosovës, nga aspekti formal-juridik është e involvuar në procesin e përshkruar më lart të monitorimit për zbatimin e kësaj konvente nga ana e Komitetit të Ministrave në kontekst të zbatimit të funksionit të saj supervisor për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke qenë se shteti akoma nuk është anëtar i barabartë i Këshillit të Evropës²¹.

4. Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA) dhe Ligji i Kontesteve Administrative (LKA) – elementët kryesor të sistemit të drejtësisë administrativ të Kosovës

Njësoj si edhe në çdo shtet tjetër, procesi i realizimit të së drejtës për qytetarët e Kosovës për kontestimin e akteve administrative të miratuara nga administrata shtetërore e Kosovës, nga aspekti formal juridik, që nga fillimi është i dizajnuar të zhvillohet në dy nivele: niveli i parë është procedura administrative, që është një instrument demokratik i krijuar për të mbrojtur personat privat (fizik e juridik) gjatë interaksioneve të drejtpërdrejta me organin relevant shtetëror administrativ, ndërsa niveli i dytë ka të bëjë me makinerinë administrative gjyqësore, me anë të së cilës personat privat në mënyrë plotësuese mund t'i kontrollojnë veprimet administrative. Faktikisht, këto dy nivele përbëjnë thelbin e sistemit të drejtësisë administrative të Kosovës.

Nga aspekti i retrospektivës, duhet të thuhet se procedura administrative (PA) në Kosovë në fillim ka qenë e rregulluar me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA) të vitit 2005, i cili ishte i dizajnuar për të qenë një vegël tradicionale e çdo demokracie

²⁰ Shih nenin 19 të Kushtetutës së Kosovës, i cili e rregullon çështjen e zbatueshmërisë së të drejtës ndërkombëtare në shtet.

²¹ Ky nen është i lidhur ngushtë me dispozitën e nenit 124, që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal. Sipas këtij neni, "Komunat gëzojnë një shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe ato nxisin dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në proceset e vendimmarrjes të organeve komunale".

(operacionalizim i garancive themelore kushtetuese për mbrojtjen e individëve nga keqpërdorimi i mundshëm nga pushteti administrativ shtetëror). Mirëpo, edhe pse teksti i këtij ligji e reflektonte qëllimin e mirë të ligjdhënësit në Kosovë për të siguruar kornizën juridike për një sistem të procedurave administrative, megjithatë ky veprim i tij qëllim-mirë nuk rezultoi me ligj përkatës, sepse po ai e vërtetoi joefikasitetin e tij të plotë²². Shkaqet për mospërshtetësin e tij (përveç tjerash) janë këto mangësi: shtrirja e këtij ligji ishte shumë e vogël, që do të thotë se nuk i mbulonte të gjitha fushat e veprimeve bashkëkohore administrative; parimi i ligjshmërisë ishte i fragmentuar; çështjet thelbësore ishin të formuluar gabimisht; procedurat ishin shumë formale dhe joefikase për qytetarin e rëndomtë; pjesëmarrja e qytetarit nuk ishte e paraparë; sistemi i mjeteve juridike ndonjëherë ishte edhe kundërthënë, etj.²³. Për të sqaruar më mirë këtë situatë duhet të themi se në rritje e sipër ishte numri i ankesave nga qytetarët për mosrespektim të LPPA-së nga administrata shtetërore e Kosovës, gjë që nuk ishte si rezultat i mungesës së kulturës administrative apo mungesës së profesionalizmit dhe integritetit të nëpunësve shtetërorë, por për shkak të cilësisë jo të mirë të këtij ligji²⁴. Nga kjo situatë mund të dilej vetëm me hartimin dhe miratimin e një Ligji krejtësisht të ri të Procedurës së Përgjithshme Administrative më 2016.

4.1. Pasqyrë e përgjithshme dhe karakteristikat kryesore të Ligjit krejtësisht të ri të Procedurës së Përgjithshme Administrative

I vlerësuar si tërësi, LPPA i ri²⁵ përmban një sërë risish të lidhura ngushtë, të cilat më mirë mund të kuptohen (përveç tjerash) për nga këto karakteristika themelore:

II). Në përgjithësi, ligji është bërë për të ulur numrin e procedurave administrative të veçanta sa më shumë të jetë e mundur. Prandaj, ligji saktësisht përcakton nocionet e çështjeve administrative dhe akteve administrative. Së këtejmi, shumë e rëndësishme është dispozita e nenit

²² A SIGMA assessment of the current Law on Administrative Procedures and proposals for enhancing the administrative practice in Kosovo “By a Better Regulatory Framework for the Relationship between citizens and the public administration”, October 2012.

²³ Ibid.

²⁴ Ibid.

²⁵ Në pajtim me nenin 162, LLPA më i ri i R. të Kosovës hyri në fuqi një vit pas shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të R. të Kosovës më 2016, gjegjësisht pas dekretimit Nr.DL-014-2016 nga kryetari i Republikës së Kosovës më 13.06.2016.

3, sipas të cilit: “1. Vullneti i organit publik merr formë në procedurën administrative dhe manifestohet në këto forma të veprimeve administrative: akt administrativ²⁶, marrëveshje administrative²⁷ apo akt real²⁸. 2. Procedura administrative është një sekuençë e unifikuar e veprimeve procedurale e materiale për përgatitjen, analizimin e veprimeve administrative konkrete, shqyrtimin e tyre me anë të mjeteve administrative ligjore dhe ekzekutimin e akteve administrative”.

III) Ai inkorporon institute të reja, siç është për shembull instituti i përmendur më parë, marrëveshje administrative, e definuar në nenin 60. Në analogji me këtë, ligji kryesisht e ka pranuar terminologjinë relevante evropiane bashkëkohore. Këtë e vërteton përdorimi i termit “shërbime me interes të përgjithshëm” që është definuar në nenin 70 të ligjit²⁹.

IV). Ligji synon të thjeshtësojë procedurën administrative³⁰ dhe të mundësojë rritjen e të drejtave të qytetarëve në çdo fazë të procedurës administrative.³¹ Për këtë qëllim ligji parashih mjete të reja ligjore (si për shembull, ankesën administrative³²) duke i modernizuar mjetet juridike tradicionale dhe duke e zvogëluar numrin e të ashtuquajturve mjete juridike të jashtëzakonshme.

E gjithë kjo që u tha deri më tani, së pari parashihet në këto parime të përgjithshme³³ të përcaktuara me LPPA-në e ri, ku përfshihen edhe disa parime të reja, si: parimi i ligjshmërisë (neni 4); parimi i proporcionalitetit (neni 5); parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 6); parimi i objektivitetit dhe paanësisë (neni 7); parimi i pritshmërive legjitime dhe të arsyeshme (neni 8); parimi i administratës së hapur

²⁶ Akti administrativ, llojet e aktit administrativ janë definuar në nenin 44 të ligjit.

²⁷ Marrëveshja administrative është definuar në paragrafin 1 të nenit 60 të ligjit.

²⁸ Akti real është definuar në nenin 69.

²⁹ Kjo, pa dyshim se buron (mes tjerash) nga dispozita e paragrafit 4 të nenit 2.

³⁰ Në këtë drejtim, përveç neneve të përmendur në vazhdim të këtij ligji, të rëndësishme janë edhe dispozitat e nenit 32 (për bashkëpunim administrativ ndërmjet vetë organeve administrative dhe neni 34 (i cili rregullon ndihmën administrative ndërmjet organeve shtetërore).

³¹ Përveç neneve të përmendur të ligjit, të rëndësishme janë edhe dispozitat (mes tjerash) e nenit 47, për strukturën dhe elementet e obligueshme të çdo akti administrativ të shkruar, neni 48 (për arsyetimin në aktin e shkruar administrativ, neni 53 (për veprimet juridike dhe procedurën e anulimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ), etj.

³² Për kundërshtimin administrativ kundër akteve reale dhe në drejtim të ofruesve të shërbimeve me interes të përgjithshëm, më tepër shih më poshtë në këtë punim.

³³ Këto i përfshin kapitulli II në pjesën I të ligjit.

(neni 9); parimi i joformalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative (neni 10); parimi i informimit dhe ndihmës aktive të palëve (neni 11); parimi i procedurës falas (neni 12)³⁴ dhe parimi i të drejtës për mjete juridike (neni 13). Këto parime të përgjithshme janë të lidhura ngushtë mes vete, të operacionalizuara dhe të plotësuara me dispozitat e neneve tjera të ligjit.

Kjo që u tha tani, kryesisht ka të bëjë me dispozitat e pjesës IV, ku janë sqaruar rregullat e përgjithshme të procedurës administrative, si edhe në kapitullin III, ku përveç tjerash janë përcaktuar edhe afatet për veprimet procedurale të palëve; Pjesa V, ku bëhet fjalë për zhvillimin e vetë procedurës administrative, ndërsa më me rëndësi është seksioni II, ku bëhet fjalë për parimet e hetimit administrativ të fakteve dhe seksioni, veçanërisht i rëndësishëm, me numër III, që e rregullon problematikën e pjesëmarrjes së palës në procedurë. Në kontekst të kësaj, doemos duhet të theksohen, përveç tjerash, këto dispozita: neni 92, i cili palës i garanton të drejtën e të pasurit mundësi për të kontrolluar dosjen dhe për të marrë informacion; neni 93, i cili palës i garanton të drejtën për të ndryshuar dhe për ta tërhequr kërkesën; neni 94, që palës, në çdo fazë të procedurës i garanton të drejtën për të dhënë mendime të veta, sqarime apo prova materiale, si dhe shumë i rëndësishmi, neni 95, me të cilin palës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar. Në kuadër të pjesës V, shumë i rëndësishëm është edhe kapitulli IV, që rregullon problematikën e dhënies fund të procedurës administrative³⁵; * Pjesa VI, për notifikimin e palëve lidhur me rrjedhën dhe rezultatin e procedurës administrative. Së këtejmi, shumë i rëndësishëm është seksioni nr. I, ku bën pjesë, përveç tjerash neni 108, i cili përcakton parimin e mënyrës adekuate të notifikimi; Pjesa VII, trajton mjetet juridike administrative. Sa i përket ankesës administrative, si mjet i rregullt juridik, së pari duhet të theksohet se ajo rregullohet në më shumë nene të ligjit, në mes të cilëve, më të rëndësishme (përveç tjerash) janë këto: neni 125, i cili përcakton kushtet e përgjithshme për parashtrimin e kësaj ankese, në bazë të të cilave kushte ankesa administrative mund të parashtrohet kundër një akti administrativ dhe në rast të mosveprimit të

³⁴ Ky parim ka lidhje të drejtpërdrejtë me dispozitat e Ligjit të Ndhmës Juridike Falas.

³⁵ Në këtë drejtim, shihe veçanërisht seksionin I, ku konkretisht janë përcaktuar parimet konkrete për ndërprerjen e procedurës administrative, si dhe seksioni II, ku janë përcaktuar afatet për ndërprerjen e procedurës administrative dhe rregulli në lidhje me heshtjen (për shembull, neni 98, sipas të cilit, procedura administrative duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 45 ditë nga dita e nisjes).

administratës, përkatësisht në rastet kur organi publik hesht përgjatë afatit të përcaktuar me ligj; neni 127 përcakton afatet për parashtrimin e kësaj ankese; neni 128 përcakton organin të cilit i drejtohet ankesa administrative dhe neni 130 përcakton veprimin suspensiv të ankesës administrative.

Duke u nisur nga kjo që u tha më lart, shumë të rëndësishme janë dispozitat të përfshira në kuadër të seksionit III të kësaj pjese, ku bëhet fjalë për procedurën e shqyrtimit të ankesës kundër aktit administrativ³⁶, Sekcioni IV flet për procedurën e shqyrtimit të ankesës në rast të heshtjes administrative³⁷, seksioni V përfshin përmbajtjen e çdo vendimi të marrë pas një ankese administrative, veprimet juridike të vendimeve të tilla³⁸, si dhe afati për të vendosur për këto ankese, i cili në bazë të nenit 135 zgjat 30 ditë nga dita e parashtrimit të ankesës. Sa i përket kundërshtimit administrativ, si mjet i rregullt juridik, duhet të theksohet se ai është i rregulluar (përveç tjerash) me nenin 136, ku shqyrtohet kundërshtimi administrativ kundër një akti real, apo në rast të mosmiratimit të një akti real nga organi publik kompetent, si dhe neni 139, me të cilin rregullohet procedura e shqyrtimit të kundërshtimit administrativ të parashtruar në rast të një shërbimi publik me interes të përgjithshëm. Përsëritja e procedurës, si mjeti i vetëm jo i rregullt juridik rregullohet me nenin 140 dhe nenin 141, në të cilët me shumë precizitet janë përcaktuar kushtet dhe afatet e shfrytëzimit të këtij mjeti. Në fund, pjesa VIII. Në të hollësisht janë rregulluar të gjitha aspektet që i përkasin ekzekutimit të akteve administrative të miratuara në përputhje me ligjin. Së këtejmi, shumë e rëndësishme është dispozita (përveç tjerash) e nenit 156, e cila palëve u garanton të drejtën e ankesës kundër veprimeve lidhur me ekzekutimin.

4.2. Vlerësimi i përgjithshëm për Ligjin e Kontesteve Administrative (LKA)

Duke u nisur nga perspektiva e qëllimit kryesor të këtij punimi dhe duke i marrë parasysh pikat kryesore të LPPA-së më të fundit, për sa i përket LKA-së aktual, i qartë është konkluzioni kryesor se, edhe pse qëllimi i ligjdhënësit kosovar me miratimin e këtij Ligji të Kontesteve Administrative (më 2010) ishte të siguronte mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe interesave të personave juridik e fizik,

³⁶Shih nenin 131 të ligjit.

³⁷ Shih veçanërisht nenin 133 të ligjit.

³⁸ Shih veçanërisht nenin 134 të ligjit.

megjithatë edhe ky ligj (njësoj sikur edhe LPPA paraprak) nxori në shesh shumë parregullsi juridike. Këto parregullsi ishin dhe akoma janë të lidhur ngushtë me shkaqet tashmë të ilustruara për miratimin e LPPA më të ri. Në këtë drejtim, mjafton të theksohet fakti se më 2013, si gjykatë e vetme për zgjidhjen e kontesteve administrative në Republikën e Kosovës ishte vetëm Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në bazë të nenit 11 të LKA-së), mirëpo kjo situatë ndryshoi me hyrjen në fuqi të Ligjit më të ri të Gjykatave më 2013³⁹, në bazë të të cilit, makineria administrativo-gjyqësore e sotme e Kosovës është e organizuar në tri nivele: Njësia e Punëve Administrative pranë Gjykatës Themelore Prishtinë⁴⁰, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme (si një nga instancat më të larta) vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike. Por, më i rëndësishëm në këtë drejtim është fakti se këtyre ndryshimeve thelbësore institucionale nga sfera e zgjidhjes së kontesteve administrative nuk u paraprinë ndryshimet adekuate plotësuese në vetë Ligjin e Kontesteve Administrative, njëri nga shkaqet kryesore për problemin e lartpërmendur⁴¹.

Kjo që u tha më lart, shumë qartë mund të vërtetohet me rastin e Republikës së Kosovës, veçanërisht pas hyrjes së paradokohshme në fuqi të LPPA-së më të ri, të ilustruar më lart (më 22 qershor të vitit 2017). Në fakt, shikuar nga kjo perspektivë, i padiskutueshëm është përfundimi se problemet aktuale në aspekt të kornizës ligjore të sistemit të drejtësisë administrative në R. e Kosovës, kryesisht i referohen kornizës tashmë të paqartë dhe të kufizuar të dispozitave të Ligjit të Kontesteve Administrative⁴², meqenëse ai, pavarësisht nga parimet kryesore të përcaktuara në të, nuk përmban rregulla procedurale të përcaktuara siç duhet për zgjidhjen në kohë, d.m.th. për zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjeve administrative, pa ndonjë vonesë të panevojshme. Të gjitha mospërputhjet selektive të ilustruara deri më

³⁹ Ligji (No. 03/L-199) i Gjykatave u miratua më 22 korrik 2010, por i njëjti (në përputhje me nenin 43) hyri në fuqi në muajin janar të vitit 2013.

⁴⁰ Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 11 të Ligjit të Gjykatave: “rastet administrative dhe komerciale janë në kompetenca ekskluzive të Gjykatës Themelore Prishtinë”.

⁴¹ Për mospërputhjen e reformave gjyqësore të Kosovës (nga viti 2013) në drejtim të etablimit të gjykatave administrative speciale të shtetit, shih te: Hysni Bajrami, *Judicial Control of the Administration in the Republic of Kosovo*, Academic Journal of Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Rome-Italy Vol 4 No 1 S1 March 2015.

⁴² Rreth dispozitave themelore të këtij ligji, më hollësisht shih te: Islam Pepaj, *Review of Administrative Justice in the Republic of Kosovo*, Academicus - International Scientific Journal 2014.

tani, në mënyrë më adekuate dhe integrale i përmban raporti i fundit i BE-së për përparimin e R. të Kosovës⁴³. Në të, mes tjerash është konstatuar:

- Vitin e ardhshëm, Kosova duhet të gjejë zgjidhje për çështjen e numrit gjithnjë e më të madh të lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën Themelore Prishtinë, të sigurojë mjete financiare për të rritur numrin e gjykatësve dhe të sigurojë kushte më të mira për punë në gjykatë;

- Administrata shtetërore ka organizim fragmentar dhe si e tillë nuk mund të sigurojë përgjegjësi efikase;

- Të drejtën e qytetarëve për administratë të mirë e ka theksuar Revizori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit⁴⁴. Rekomandimet e tyre nuk janë implementuar sistematikisht;

- Ligji i ri i Procedurës së Përgjithshme Administrative, i miratuar në maj të vitit 2016 duhet të përmirësojë të drejtën për drejtësi administrative së bashku me Ligjin e Kontesteve Administrative, i cili është në plan për miratim⁴⁵. Numri gjithnjë e më i madh i kontesteve të pazgjidhura është në dëm të besimit të opinionit ndaj sistemit gjyqësor⁴⁶.

- E drejta për kompensim nuk është siguruar akoma, duke qenë se legjislacioni është fragmentar dhe nuk ekziston asnjë ligj konkret për përgjegjësi publike”.

Kjo situatë faktike ka edhe dimensione tjera. Të këtilla janë zbrazëtirat në legjislacion, veçanërisht mosimplementimi i Ligjit të Ndhmës Ligjore Falas⁴⁷ dhe çështjet lidhur me sistemin e vetëqeverisjes lokale të shtetit⁴⁸. Të gjitha këto mangësi të detektuar, ku

⁴³ Brussels, 9.11.2016 SWD(2016) 363 final COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2016 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2016 Communication on EU Enlargement Policy {COM(2016) 715 final}.

⁴⁴Shihe raportin e fundit të Avokatit të Popullit të Kosovës për vitin 2016, i cili mund të shihet në: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/1072-2016_Raport_me_rekomandime_680722.pdf.

⁴⁵Më shumë rreth miratimit të LKA-së më të ri në Republikën e Kosovës, shih në: Consultation Document on draft Concept Paper on Administrative Disputes, MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKEMINISTARSTVO JAVNE UPRAVNE /MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION, prill 2017.

⁴⁶Më shumë shih në: Supra note nr.66.

⁴⁷Për më shumë shih te: Shibani Shah, Legal aid in Kosovo: The gap between law and practice, 2014, пристаплив на <https://www.fairtrials.org/access-to-legal-aid-in-kosovo>.

⁴⁸Shihe raportin përfundimtar të titulluar: “Rule of law in public administration in Kosovo” I përgatitur në kuadër të projektit “Measuring Rule of Law in Public

bën pjesë edhe mungesa e implementimit sistematik të vendimeve administrative gjyqësore vendase, janë të lidhura drejtpërdrejt apo jodrejtpërdrejt me të drejtat pronësore. Këto sërish janë riafirmuar qartë me Memorandumin e botuar më 2017 nga Komisari i të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, ku hollësisht janë vënë në pah fushat, në të cilat ka nevojë urgjente për intervenim. Në këtë mënyrë jepet mundësia për të pasur funksionim efikas të sistemit të drejtësisë administrative në Kosovë⁴⁹.

Rrjedhimisht, nga kjo që u tha më lart, përgatitja dhe miratimi i një ligji të ri kosovar për kontestet administrative është një nga kushtet elementare, respektivisht kjo është kërkesë e Komisionit Evropian e parashtruar në raportin e theksuar më lart, ku trajtohen çështjet e përparimit të shtetit dhe afrimit të saj me BE-në. Po kjo, është paraparë edhe në planin vjetor të Qeverisë së Kosovës për vitin 2017. Se kjo çështje është vënë në plan të parë, e vërteton edhe dokumenti konsultativ në versionin draft lidhur me kontestet administrative i botuar nga Qeveria e Kosovës në muajin prill të vitit 2017⁵⁰.

CONCLUSIONS

The system of administrative law of any modern state is designed to serve the two main mandates: to ensure the legitimacy of the activities of administrative powers and to guarantee the protection of the rights and interests of private persons (physical and legal).. Based on these two mandates, viewed from the perspective of their principles, administrative justice was designed to establish a system of legal review and control of administrative actions. Say otherwise, the relationship between these two mandates lies in the fact that good public administration has advantages and benefits for individuals and for the state itself. In other words, even the best political concepts of a country that deal with matters directly related to the interests of ordinary citizens will always end up as unsuccessful if its public administration does not have the appropriate capacity to implement these concepts in practice.

Administration in Kosovo Municipalities”, 2016, që mund të shihet në:<https://fba.se/.../rule-of-law-in-public-administration-in-kosovo>.

⁴⁹ <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/justice-social-cohesion-and-media-freedom-remain-top-challenges-in-kosovo-?desktop=true>

⁵⁰ Supra note 72.

In this context lies the importance of a functioning public administration for the development of the economy, an internationally recognized fact. Inadequate administration, with many administrative shortfalls and lengthy and unnecessary administrative procedures, hampers the economic initiatives of potential domestic and foreign investors, results in adverse effects on employment and political stability.

This formal strategic goal, unfortunately, has not been achieved efficiently by the Republic of Kosovo until today. Apart from the lack of administrative culture and the lack of professionalism and/or integrity of civil servants, in the background of this failure lies the poor quality of the first LPPA (since 2005). This law remained completely ineffective, though reflecting the good intention of the Kosovo legislator to provide the legal framework for a good system of administrative procedures. Today, this situation can be completely overcome with the proper implementation of the new LPP from 2016, which entered into force in 2017. The above-mentioned imperative to ensure direct connection of administrative procedures and the administrative court, in which national democratic context, de facto are the two main pillars of the legal protection system of the rights of private persons (physical and legal) in the administrative sphere.

Apart from the fact that we have pointed out a little earlier, in the case of the Republic of Kosovo, it is very important to mention the fact that the current process of building an administrative justice system has been and still continues to be influenced (among others) by the case still, the current status of its international status, namely with international recognition and membership in all international intergovernmental organizations. Even though Kosovo, immediately after the declaration of its independence, started the reform process and the consolidation of the institutions (unlike all the Balkan countries), to this point it is not yet an equal member of the (essentially) Council of Europe. Until now, it has not been able to feel the true "state of the art" benefits of being an equal member of the organization, which for many years enjoys all neighboring states. Hence, in the case of the Republic of Kosovo, a special catalyst input for the achievement of its strategic goals in the field of administrative law may be formally-legal membership in the Council of Europe or at least its provisional inclusion as a contracting member of the Convention on Human Rights. This means giving every citizen of Kosovo and any other person located in its territory (regardless of ethnic, religious origin etc.) to enjoy the same

rights as citizens of all neighboring states. In the existence of the possibility of filing complaints at the European Court of Human Rights against the Republic of Kosovo would be executed in the framework of the monitoring process conducted by the Committee of Ministers of this organization. This would increase the presence of a sense of the added value of the judicial experience of the European Court of Human Rights whose value (although formally recognized by the Constitution of the Republic of Kosovo) would have practical relevance and impact on the system of today's administrative justice of Kosovo. This development would ultimately serve to fulfill all the obligations of the Republic of Kosovo deriving from the Stabilization and Association Agreement with the EU, including in particular the obligation to build European administrative capacity. Finally, based on what we have said so far, we must mention the fact that all of the future concrete steps of Republic of Kosovo in the area of administrative justice will not give the final effect if in the following period does not pay attention to the necessity to strengthen all relevant monitoring instances, particularly the Office of the Ombudsman and the administrative capacities of local governments within the local self-government units for active citizen participation. All of this, in a word, requires a completely new approach and at least a strong state government.

I. LITERATURA E SHFRYTËZUAR SELEKTIVE

1. Arman Zrvandyan, *Casebook on European fair trial standards in administrative justice* (2016), ISBN 978-92-871-8395-8.

2. Bradley, A. W., "The European Convention on Human Rights and Administrative Law: First Impressions", (1983) 21 *Osgoode Hall Law Journal* 4, стр. 615.

3. Grizo, N., Gelevski, S., Davitkovski B., & Pavlovska-Daneva A. (2008). *Административно право [Administrative law]*. Skopje, Republic of Macedonia: Iustinianus Primus Faculty of Law in Skopje.

4. Гелевски, С, *Судска контрола над управни акти*, Зборник на Правниот факултет „Јустинијан Први“ во Скопје, 2010, стр. 149.

5. Elisabeth Lambert-Abdelgawad, *L'exécution des arrêts de la Cour Européenne des Droits de l'Homme* (Council of Europe 2005) 82.

6. David Harris, et al, *Law of the European Convention on Human Rights*. (2nd ed., Oxford University Press, 2009) 30.

7. Hysni Bajrami, Judicial Control of the Administration in the Republic of Kosovo, Academic Journal of Interdisciplinary Studies MCSER Publishing, Rome-Italy Vol 4 No 1 S1 March 2015.

8. Islam Pepaj, Review of Administrative Justice in the Republic of Kosovo, Academicus - International Scientific Journal 2014.

9. Koprić, Ivan (2011). Administrative Technology and General Administrative Procedure: Challenges and Changes in South-Eastern Europe. Croatian and Comparative Public Administration / Hrvatska i komparativna javna uprava, 11(2): 435–454.

10. Koprić, I., Musa, A., & Lalić Novak, G. (2011). Good administration as a ticket to the European administrative space. Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, 61(5), 1515-1560.

11. Mendes, J. (2009). Good Administration in EU Law and the European Code of Good Administrative Behaviour, European University Institute, EUI Working papers, Law 2009/09, Department of Law: 1-19.

12. Shibani Shah, Legal aid in Kosovo: The gap between law and practice, 2014, пристаплив на <https://www.fairtrials.org/access-to-legal-aid-in-kosovo>.

13. Silvia Mirate, “The ECtHR Case Law as a Tool for Harmonization of Domestic Administrative Laws in Europe”, (2012) 5 Review of European Administrative Law 2, стр. 48.

14. Victor O Ayeni, THE OMBUDSMAN IN THE ACHIEVEMENT OF ADMINISTRATIVE JUSTICE AND HUMAN RIGHTS IN THE NEW MILLENNIUM, Published in International Ombudsman Journal, Volume 5, 2001, стр. 32-53.

15. Woehrling, J.-M., Judicial Control of Administrative Authorities in Europe: Toward a Common Model, Papers presented at the “Regional Workshop on Public Administration Reform and EU Integration”, Budva, 5-6 December 2005.

II. RAPORTE DHE WEB-FAQE TË SHFRYTËZUARA

- Ministritë relevante të Qeverisë së republikës së Kosovës (veçanërisht Ministrinë e Administratës Publike);
- Avokati i Popullit të Kosovës (www.ombudspersonkosovo.org);
- Kuvendi Kombëtar i Republikës së Kosovës (<http://www.assembly-kosova>);

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
- Këshilli i Evropës (Komiteti i Ministrave, Zyra e Kontratave, Komesari Evropian i të Drejtave të Njeriut, Gjykata evropiane e të Drejtave të Njeriut, etj.);
- Komisioni Evropian i BE-së;
- Misioni i OSBE-së në Republikën e Kosovës;
- Western Balkans Recommendation on Public Participation, as endorsed by ministers in charge for public administration from Western Balkan countries at the ReSPA Governing Board meeting held on 6 November 2017 in Tirana, Albania, Regional School of Public Administration, Danilovgrad, Montenegro , respaweb.eu ;
- Regional School of Public Administration (ReSPA), Study on the Case-Law of the European Court of Human Rights Applicable in Administrative Disputes, 2017, mund të shihet në: www.respaweb.eu ;
- “A SIGMA assessment of the current Law on Administrative Procedures and proposals for enhancing the administrative practice in Kosovo “By a Better Regulatory Framework for the Relationship between citizens and the public administration”, October 2012, mund të shihet në: www.sigmaweb.org .
- OECD (1999), “European Principles for Public Administration”, Sigma Papers, No. 27, OECD Publishing, 1999, [URL: <http://dx.doi.org/10.1787/5kml60zwd7h-en>]. The Principles of Public Administration: A Framework for ENP Countries, OECD/SIGMA; www.sigmaweb.org, dhe
- Kosovo Law Institute (KLI) Institute, Research Paper on Effective Legal Remedies in Administrative Justice, Prishtina, September 2017, faqe 18.;
- Raporti i titulluar “Rule of law in public administration in Kosovo” i përgatitur në kaudër të projektit “Measuring Rule of Law in Public Administration in Kosovo Municipalities”, 2016, mund të shihet në: <https://fba.se/.../rule-of-law-in-public-administration-in-Kosovo>